



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



Anr.501/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Adnan Konushevci dhe Rrustem Thaqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Faton Xhaqkaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e ankuesit Abedin Çitaku, nga Podujeva, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – Thyerja e heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datën 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 16.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuara ankesa A.nr.501/2021, e ankuesit Abedin Çitaku, nga Podujeva, ndërsa subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje i shqiptohet gjobë në lartësi prej 3,000.00 (tremijë) euro, në emër të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – Thyerja e heshtjes zgjedhore.

II. DETYROHET subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, që gjobën e shqiptuar si në pikën - I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Paneli, me datën 15 shkurt 2021 ka pranuar ankesën A.nr.501/2021, të parashtruar nga Abedin Çitaku, nga Podujeva,, me të cilin pretendon se i është dërguar sms, në telefon me datë 13.02.2021 ora 20:45, voto Albin Kurtin nr.1.

Në përgjigje në ankesë të datës 16.02.2021, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka kundërshtuar ankesën, duke pretenduar se me të marrë njoftimin se nga numri telefonik 045220079, qytetarëve të Kosovës i është dërguar sms, me të cilin është kërkuar të votohet Lëvizja Vetëvendosje, nëpërmes emailit i është drejtuar Prokurorisë së Shtetit, me kërkesë për fillimin e hetimeve me qëllim të parandalimit të këtij veprimi, sepse ky sms nuk është dërguar nga zyrtarët e Lëvizjes Vetëvendosje, përkatësisht është dërguar pa autorizimin e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje. Ka propozuar që ankesa të refuzohet si e pa bazuar. Bashkangjitur me përgjigje në ankesë si provë është emali dërguar prokurorisë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave, e posaçërisht nga foto e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se

subjekti politik VV respektivisht mbështetësit e subjektit në fjalë, përmes SMS ka/kanë bere thirrje tek qytetaret e Kosovës që të votohet subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje me nr.127 dhe kryetari i këtij subjekti politik Albin Kurti, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 36.1 pika b) e LZP-së, e cila përcakton *“Njëzet e katër (24) orë para hapjes së Qendrës te Votimit për hedhjen e votës, e deri ne mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve te tyre u ndalohe bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Parashtrimet në përgjigje në ankesë, se subjekti politik VV se nuk ka dërguar asnjë SMS tek qytetaret dhe se e njëjta nuk është e implikuar në dërgimin e këtyre SMS-ve, paneli e vlerëson si jo relevante, për faktin se mesazhet janë dërguar në emër dhe për llogari të subjektit në fjalë, ku nga fotot e bashkangjitura në ankesë shihet çartë se SMS të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me numër rendor 127 me të cilin garoi në zgjedhjet e 14 shkurt 2021 iu është drejtuar qytetareve të Kosovës duke iu bërë thirrje që të votohet subjekti politik LVV dhe kryetari i saj Albin Kurti, veprime këto qe janë ne kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 36 .1 pika b) i LZP-së, ku përcaktohen veprimet e ndaluara para procesit të votimit nga ana e subjekteve politike. Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së subjekti politik VV, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e rregullave dhe Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me Rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur më fushatën zgjedhore. Paneli po ashtu me rastin e përcaktimit për lartësinë e gjobës ka marrë parasysh edhe përgjigjen në ankesë të subjektit politik.

Paneli vlerëson se kjo mënyrë e të bërit fushatë qoftë drejtpërdrejt nga subjekti apo në emër dhe për llogari të subjektit nga mbështetësit e subjektit, cenon lirinë e përcaktimit të qytetarit duke e shqetësuar dhe duke tentuar që të ndikoj tek i njëjti për përcaktimin e tij për të votuar. Subjekti në emër dhe për llogari për të cilin është bërë thirrja për të votuar asnjëherë publikisht nuk ka mohuar se kjo fushat është e drejtuar nga ana e tyre apo përkrahësve të tyre, por reagimi i vetëm ka qenë përmes përgjigjes së shkurtër në ankesë dërguar në Panel.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje

në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin jo relevante dhe pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendos.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 501/2021 më datën 16.02.2021

Kryesuesi i Panelit

Zyhdi Haxhiu



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së,